	Detyrime të Prapambetura	Totali i Shpenzimeve Faktike 2023	% e Detyrimeve ndaj Totalit të Shpenzimeve Faktike
Bashkia Skrapar	15,062,317	348,186,226	4.33%
Totali NJVQVB	4,752,754,032	68,336,294,762	6.95%
Mesatarja NJVQV-Bashki			9.51%

Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Treguesi i vështirësisë financiare është përmirësuar në vitet e fundit, duke u reduktuar në 4.33% në vitin 2023 (Grafiku nr. 108).

Grafiku nr.108 Ecuria e Statutit të Vështirësisë Financiare të Bashkisë Skrapar 2019-2023



Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Sipas raportimit deri në dhjetor, detyrimet janë rreth 15 milionë lekë, kryesisht për shpenzime korrente e për vendime gjyqësore (Tabela nr. 112).


Tabela nr.112 Struktura e Detajuar e Detyrimeve të Prapambetura të Bashkisë Skrapar, Dhjetor 2023 (në lekë)

Nr.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve faktike për NJQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale faktike të NJQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua afatgjatë	0		
a.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)			
a.2	Tituj të emetuar			
a.3	Garanci për të tretë	0		
b	Hua afatshkurtër			
b.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)			
b.2	Tituj të emetuar			
b.3	Garanci për të tretë			
II	Detyrimet e prapambetura	15,062,317		
Llogaria ekonomike	Emërtimi			
4864100	Vendime Gjyqesore	5,017,764		
4864200	Det.Prap. Sherbime	340,432		
4864201	Det.Prap. Energji Elektrike		348,186,226	4.33%
4864300	Det.Prap. Mirembajtje	4,450,639		
4864400	Det.Prap. Investime	901,200		
4864500	Det.Prap. Rimbursim TVSH			
4864600	Mallra	1,464,332		
4864900	Det.Prap. Te Tjera	2,887,950		
4864601	Det.Prap. Sig.Shoqerore			
4864602	Det.Prap. Sig.Shendet			
4864603	Det.Prap. Ardh.Personal			
4864604	Det.Prap. Tatime Tjera			
4864901	Paga			
4864902	Shpronetime			
4864903	Trans. Individeve			
4864904	Trans. Subjektet			
III	Totali (I+II)	15,062,317		

Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Në krahasim me vitin 2022, në vitin 2023 kemi një rritje të detyrimeve për vendime gjyqësore dhe një ulje të detyrimeve për shpenzime korrente dhe kapitale. (Grafiku nr. 109).

Grafiku nr.109 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Skrapar 2019-2023



Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Bashkia Shijak

Detyrimet e prapambetura deri në dhjetor 2023 janë 0.03% e shpenzimeve totale faktike në Bashkinë e Shijakut, më pak se 15% duke dëshmuar për një situatë normale financiare. Situata është nën mesataren e % së Detyrimeve ndaj Totalit të Shpenzimeve Faktike mes të gjitha bashkive (9.51%) dhe nën treguesin e totalit të detyrimeve të prapambetura ndaj shpenzimeve faktike të njëjësive vendore (6.95%) (Tabela nr. 113).


Tabela nr.113 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Shijak, Dhjetor 2023

	Detyrime të Prapambetura	Totali i Shpenzimeve Faktike 2023	% e Detyrimeve ndaj Totalit të Shpenzimeve Faktike
Bashkia Shijak	136,649	434,290,859	0.03%
Totali NJVQVB	4,752,754,032	68,336,294,762	6.95%
Mesatarja NJVQV-Bashki			9.51%

Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Treguesi i vështirësisë financiare ka qenë relativisht i ulët dhe është reduktuar ndjeshëm drejt zeros në vitin 2023 (Grafiku nr. 110).

Grafiku nr.110 Ecuria e Statutit të Vështirësisë Financiare të Bashkisë Shijak 2019-2023



Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Sipas raportimit deri në dhjetor, detyrimet janë rreth 0.1 milionë lekë me detyrime kyesisht për shpenzime korrente për shërbime (Tabela nr. 114).


Tabela nr.114 Struktura e Detajuar e Detyrimeve të Prapambetura të Bashkisë Shijak, Dhjetor 2023 (në lekë)

Nr.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale faktike të NJVQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua afatgjatë	0		
a.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)			
a.2	Tituj të emetuar			
a.3	Garanci për të tretë	0		
b	Hua afatshkurtër			
b.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)			
b.2	Tituj të emetuar			
b.3	Garanci për të tretë			
II	Detyrimet e prapambetura	136,649		
Llogaria ekonomike	Emërtimi			
4864100	Vendime Gjyqesore			
4864200	Det.Prap. Sherbime	136,649		
4864201	Det.Prap. Energji Elektrike		434,290,859	0.03%
4864300	Det.Prap. Mirembajtje			
4864400	Det.Prap. Investime			
4864500	Det.Prap. Rimbursim TVSH			
4864600	Mallra			
4864900	Det.Prap. Te Tjera			
4864601	Det.Prap. Sig.Shoqerore			
4864602	Det.Prap. Sig.Shendet			
4864603	Det.Prap. Ardh.Personal			
4864604	Det.Prap. Tatime Tjera			
4864901	Paga			
4864902	Shpronetime			
4864903	Trans. Individeve			
4864904	Trans. Subjektet			
III	Totali (I+II)	136,649		

Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Në krahasim me vitin 2022, në vitin 2023 të gjitha detyrimet janë për shpenzime korrente, pasi janë shlyer të gjitha detyrimet për vendime gjyqësore dhe për shpenzime korrente (Grafiku nr. 111).

Grafiku nr.111 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Shijak 2020-2023



Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Bashkia Shkodër

Detyrimet e prapambetura deri në dhjetor 2023 janë 0.03% e shpenzimeve totale faktike në Bashkinë e Shkodrës, pothuajse zero duke dëshmuar për një situatë normale financiare. Situata është nën mesataren e % së Detyrimeve ndaj Totalit të Shpenzimeve Faktike mes të gjitha bashkive (9.51%) dhe nën treguesin e totalit të detyrimeve të prapambetura ndaj shpenzimeve faktike të njëjësive vendore (6.95%) (Tabela nr. 115).


Tabela nr.115 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Shkodër, Dhjetor 2023

	Detyrime të Prapambetura	Totali i Shpenzimeve Faktike 2023	% e Detyrimeve ndaj Totalit të Shpenzimeve Faktike
Bashkia Shkodër	571,032	2,067,501,667	0.03%
Totali NJVQVB	4,752,754,032	68,336,294,762	6.95%
Mesatarja NJVQV-Bashki			9.51%

Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Treguesi i vështirësisë financiare ka qenë mjaft i ulët në pesë vitet e fundit, duke arritur në 2023 në vlera pothuajse zero (Grafiku nr. 112).

Grafiku nr.112 Ecuria e Statutit të Vështirësisë Financiare të Bashkisë Shkodër 2019-2023



Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Sipas raportimit deri në dhjetor, detyrimet janë rreth 0.6 milionë lekë me detyrime vetëm për shpenzime korrente për prokurim shërbimesh dhe detyrime të tjera tatimore (Tabela nr. 116).


Tabela nr.116 Struktura e Detajuar e Detyrimeve të Prapambetura të Bashkisë Shkodër, Dhjetor 2023 (në lekë)

Nr.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale faktike të NJVQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua afatgjatë	0		
a.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)			
a.2	Tituj të emetuar			
a.3	Garanci për të tretë	0		
b	Hua afatshkurtër			
b.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)			
b.2	Tituj të emetuar			
b.3	Garanci për të tretë			
II	Detyrimet e prapambetura	571,032		
Llogaria ekonomike	Emërtimi			
4864100	Vendime Gjyqesore			
4864200	Det.Prap. Sherbime	311,394		
4864201	Det.Prap. Energji Elektrike		2,067,501,667	0.03%
4864300	Det.Prap. Mirembajtje			
4864400	Det.Prap. Investime			
4864500	Det.Prap. Rimbursim TVSH			
4864600	Mallra			
4864900	Det.Prap. Te Tjera			
4864601	Det.Prap. Sig.Shoqerore	17,676		
4864602	Det.Prap. Sig.Shendet			
4864603	Det.Prap. Ardh.Personal			
4864604	Det.Prap. Tatime Tjera	241,962		
4864901	Paga			
4864902	Shpronetime			
4864903	Trans. Individeve			
4864904	Trans. Subjektet			
III	Totali (I+II)	571,032		

Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Në vitin 2023 të gjitha detyrimet janë detyrime për shpenzime korrente, njësoj si në vitin 2022. (Grafiku nr. 113).

Grafiku nr.113 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Shkodër 2019-2022



Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Bashkia Tepelenë

Detyrimet e prapambetura deri në dhjetor 2023 janë 12.27% e shpenzimeve totale të miratuara në Bashkinë e Tepelenës, më pak se 15% duke dëshmuar për një situatë normale financiare. Situata është mbi mesataren e % së Detyrimeve ndaj Totalit të Shpenzimeve Faktike mes të gjitha bashkive (9.51%) dhe mbi treguesin e totalit të detyrimeve të prapambetura ndaj shpenzimeve faktike të njëjësive vendore (6.95%) (Tabela nr. 117).


Tabela nr.117 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Tepelenë, Dhjetor 2023

	Detyrime të Prapambetura	Totali i Shpenzimeve Faktike 2023	% e Detyrimeve ndaj Totalit të Shpenzimeve Faktike
Bashkia Tepelenë	33,874,193	276,060,112	12.27%
Totali NJVQVB	4,752,754,032	68,336,294,762	6.95%
Mesatarja NJVQV-Bashki			9.51%

Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Treguesi i vështirësisë financiare është përmirësuar ndjeshëm në katër në vitet e fundit. Në vitin 2023 kemi një rritje në 12.27% (Grafiku nr. 114).

Grafiku nr.114 Ecuria e Statutit të Vështirësisë Financiare të Bashkisë Tepelenë 2019-2023



Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Sipas raportimit deri në dhjetor 2023, detyrimet janë rreth 34 milionë lekë, kryesisht për shpenzime korrente për mallra e shërbime (Tabela nr. 118).


Tabela nr.118 Struktura e Detajuar e Detyrimeve të Prapambetura të Bashkisë Tepelenë, Dhjetor 2023 (në lekë)

Nr.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve faktike për NJQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale faktike të NJQV-së		
I	Borxhe (a+b)	0				
a	Hua afatgjatë	0				
a.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)					
a.2	Tituj të emetuar					
a.3	Garanci për të tretë	0				
b	Hua afatshkurtër					
b.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)					
b.2	Tituj të emetuar					
b.3	Garanci për të tretë					
II	Detyrimet e prapambetura	33,874,193				
Llogaria ekonomike	Emërtimi					
4864100	Vendime Gjyqesore	122,999	276,060,112	12.27%		
4864200	Det.Prap. Sherbime	3,518,978				
4864201	Det.Prap. Energji Elektrike					
4864300	Det.Prap. Mirembajtje	3,317,713				
4864400	Det.Prap. Investime	5,528,329				
4864500	Det.Prap. Rimbursim TVSH					
4864600	Mallra	14,565,302				
4864900	Det.Prap. Te Tjera	6,820,872				
4864601	Det.Prap. Sig.Shoqerore					
4864602	Det.Prap. Sig.Shendet					
4864603	Det.Prap. Ardh.Personal					
4864604	Det.Prap. Tatime Tjera					
4864901	Paga					
4864902	Shpronetime					
4864903	Trans. Individeve					
4864904	Trans. Subjektet					
III	Totali (I+II)	33,874,193				

Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Në krahasim me vitin 2022, në vitin 2023 kemi një rritje të detyrimeve për shpenzime korrente dhe një rënie të detyrimeve për shpenzime kapitale (Grafiku nr. 115).

Grafiku nr.115 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Tepelenë 2019-2023



Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Bashkia Tiranë

Detyrimet e prapambetura deri në dhjetor 2023 janë 3.44 % e shpenzimeve totale faktike në Bashkinë e Tiranës, më pak se 15% duke dëshmuar për një situatë normale financiare. Situata është nën mesataren e % së Detyrimeve ndaj Totalit të Shpenzimeve Faktike mes të gjitha bashkive (9.51%) dhe nën treguesin e totalit të detyrimeve të prapambetura ndaj shpenzimeve faktike të njëjësive vendore (6.95%) (Tabela nr. 119).


Tabela nr.119 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Tiranë, Dhjetor 20223

	Detyrime të Prapambetura	Totali i Shpenzimeve Faktike 2023	% e Detyrimeve ndaj Totalit të Shpenzimeve Faktike
Bashkia Tiranë	788,088,174	22,882,667,205	3.44%
Totali NJVQVB	4,752,754,032	68,336,294,762	6.95%
Mesatarja NJVQV-Bashki			9.51%

Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Treguesi i vështirësisë financiare ka qenë i ulët në pesë vitet e fundit. Në vitin 2023 kemi një rënie të lehtë të treguesit në 3.44% (Grafiku nr. 116).

Grafiku nr.116 Ecuria e Statutit të Vështirësisë Financiare të Bashkisë Tiranë 2019-2023



Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Sipas raportimit deri në dhjetor 2023, detyrimet janë rreth 788 milionë lekë, kryesisht për shpenzime korrente për mallra e shërbime, detyrime të tjera, për detyrime fiskale dhe shpenzime kapitale (Tabela nr. 120).


Tabela nr.120 Struktura e Detajuar e Detyrimeve të Prapambetura të Bashkisë Tiranë, Dhjetor 2023 (në lekë)

Nr.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale faktike të NJVQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua afatgjatë	0		
a.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)			
a.2	Tituj të emetuar			
a.3	Garanci për të tretë	0		
b	Hua afatshkurtër			
b.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)			
b.2	Tituj të emetuar			
b.3	Garanci për të tretë			
II	Detyrimet e prapambetura	788,088,174		
Llogaria ekonomike	Emërtimi			
4864100	Vendime Gjyqesore	11,991,976		
4864200	Det.Prap. Sherbime	16,817,266		
4864201	Det.Prap. Energji Elektrike		22,882,667,205	3.44%
4864300	Det.Prap. Mirembajtje	331,527		
4864400	Det.Prap. Investime	153,159,364		
4864500	Det.Prap. Rimbursim TVSH			
4864600	Mallra			
4864900	Det.Prap. Te Tjera	588,741,176		
4864601	Det.Prap. Sig.Shoqerore	8,827,961		
4864602	Det.Prap. Sig.Shendet	15,779		
4864603	Det.Prap. Ardh.Personal	5,396,164		
4864604	Det.Prap. Tatime Tjera	2,806,961		
4864901	Paga			
4864902	Shpronetime			
4864903	Trans. Individeve			
4864904	Trans. Subjektet			
III	Totali (I+II)	788,088,174		

Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Në krahasim me vitin 2022, në vitin 2023 kemi një rritje të detyrimeve për shpenzime korrente shoqëruar me uljen e detyrimeve për vendime gjyqësore (Grafiku nr. 117).

Grafiku nr.117 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Tiranë 2019-2023



Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Bashkia Tropojë

Detyrimet e prapambetura deri në dhjetor 2023 janë 10.90% e shpenzimeve totale faktike në Bashkinë e Tropojës, më pak se 15% duke dëshmuar për një situatë pa probleme financiare. Situata është mbi mesataren e % së Detyrimeve ndaj Totalit të Shpenzimeve Faktike mes të gjitha bashkive (9.51%) dhe mbi treguesin e totalit të detyrimeve të prapambetura ndaj shpenzimeve faktike të njëjësive vendore (6.95%) (Tabela nr. 121).


Tabela nr.121 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Tropojë, Dhjetor 2023

	Detyrime të Prapambetura	Totali i Shpenzimeve Faktike 2023	% e Detyrimeve ndaj Totalit të Shpenzimeve Faktike
Bashkia Tropojë	48,703,865	446,884,426	10.90%
Totali NJVQVB	4,752,754,032	68,336,294,762	6.95%
Mesatarja NJVQV-Bashki			9.51%

Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Treguesi i vështirësisë financiare është përmirësuar në pesë vitet e fundit, duke u reduktuar më tej në 2023 në 10.90% (Grafiku nr. 118).

Grafiku nr.118 Ecuria e Statutit të Vështirësisë Financiare të Bashkisë Tropojë 2019-2023



Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Sipas raportimit deri në dhjetor, detyrimet janë rreth 49 milionë lekë, kryesisht për shpenzime kapitale (Tabela nr. 122).


Tabela nr.122 Struktura e Detajuar e Detyrimeve të Prapambetura të Bashkisë Tropojë, Dhjetor 2023 (në lekë)

Nr.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale faktike të NJVQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua afatgjatë	0		
a.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)			
a.2	Tituj të emetuar			
a.3	Garanci për të tretë	0		
b	Hua afatshkurtër			
b.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)			
b.2	Tituj të emetuar			
b.3	Garanci për të tretë			
II	Detyrimet e prapambetura	48,703,865		
Llogaria ekonomike	Emërtimi			
4864100	Vendime Gjyqesore	1,384,443		
4864200	Det.Prap. Sherbime	1,278,783		
4864201	Det.Prap. Energji Elektrike		446,884,426	10.90%
4864300	Det.Prap. Mirembajtje	1,299,766		
4864400	Det.Prap. Investime	40,745,873		
4864500	Det.Prap. Rimbursim TVSH			
4864600	Mallra	3,995,000		
4864900	Det.Prap. Te Tjera			
4864601	Det.Prap. Sig.Shoqerore			
4864602	Det.Prap. Sig.Shendet			
4864603	Det.Prap. Ardh.Personal			
4864604	Det.Prap. Tatime Tjera			
4864901	Paga			
4864902	Shpronetime			
4864903	Trans. Individeve			
4864904	Trans. Subjektet			
III	Totali (I+II)	48,703,865		

Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Në krahasim me vitin 2022, në vitin 2023 kemi një rritje të detyrimeve për shpenzime korrente dhe ulje të detyrimeve për shpenzime kapitale (Grafiku nr. 119).

Grafiku nr.119 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Tropojë 2019-2023



Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Bashkia Vau i Dejës

Detyrimet e prapambetura deri në dhjetor 2023 janë 2.25% e shpenzimeve totale faktike në Bashkinë e Vaut të Dejës, nën 15%, duke dëshmuar për një situatë normale financiare. Situata është nën mesataren e % së Detyrimeve ndaj Totalit të Shpenzimeve Faktike mes të gjitha bashkive (9.51%) dhe nën treguesin e totalit të detyrimeve të prapambetura ndaj shpenzimeve faktike të njëjësive vendore (6.95%) (Tabela nr. 123).


Tabela nr.123 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Vau i Dejës, Dhjetor 2023

	Detyrime të Prapambetura	Totali i Shpenzimeve Faktike 2023	% e Detyrimeve ndaj Totalit të Shpenzimeve Faktike
Bashkia Vau i Dejës	12,575,661	559,438,181	2.25%
Totali NJVQVB	4,752,754,032	68,336,294,762	6.95%
Mesatarja NJVQV-Bashki			9.51%

Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Treguesi i vështirësisë financiare ka qenë mjaft i ulët në pesë vitet e fundit, duke pësuar një rritje të lehtë në 2023 në 2.25% (Grafiku nr. 120).

Grafiku nr.120 Ecuria e Statutit të Vështirësisë Financiare të Bashkisë Vau i Dejës 2019-2023



Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Sipas raportimit deri në dhjetor, detyrimet janë rreth 13 milionë lekë, kryesisht për shpenzime kapitale, prokurim mallrash dhe vendime gjyqësore (Tabela nr. 124).


Tabela nr.124 Struktura e Detajuar e Detyrimeve të Prapambetura të Bashkisë Vau i Dejës, Dhjetor 2023 (në lekë)

Nr.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale faktike të NJQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua afatgjatë	0		
a.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)			
a.2	Tituj të emetuar			
a.3	Garanci për të tretë	0		
b	Hua afatshkurtër			
b.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)			
b.2	Tituj të emetuar			
b.3	Garanci për të tretë			
II	Detyrimet e prapambetura	12,575,661		
Llogaria ekonomike	Emërtimi			
4864100	Vendime Gjyqësore	3,342,860		
4864200	Det.Prap. Sherbime		559,438,181	2.25%
4864201	Det.Prap. Energji Elektrike			
4864300	Det.Prap. Mirembajtje			
4864400	Det.Prap. Investime	5,051,281		
4864500	Det.Prap. Rimbursim TVSH			
4864600	Mallra	4,181,520		
4864900	Det.Prap. Te Tjera			
4864601	Det.Prap. Sig.Shoqerore			
4864602	Det.Prap. Sig.Shendet			
4864603	Det.Prap. Ardh.Personal			
4864604	Det.Prap. Tatime Tjera			
4864901	Paga			
4864902	Shpronetime			
4864903	Trans. Individeve			
4864904	Trans. Subjektet			
III	Totali (I+II)	12,575,661		

Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Në krahasim me vitin 2022, në vitin 2023 një pjesë e detyrimeve për vendime gjyqësore janë shlyer dhe janë rritur detyrimet për shpenzime kapitale e korrente (Grafiku nr. 121).

Grafiku nr.121 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Vau i Dejës 2019-2023



Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Bashkia Vlorë

Detyrimet e prapambetura deri në dhjetor 2023 janë 2.47% e shpenzimeve totale faktike në Bashkinë e Vlorës, më pak se 15% duke dëshmuar për një situatë normale financiare. Situata është nën mesataren e % së Detyrimeve ndaj Totalit të Shpenzimeve Faktike mes të gjitha bashkive (9.51%) dhe nën treguesin e totalit të detyrimeve të prapambetura ndaj shpenzimeve faktike të njëjësive vendore (6.95%) (Tabela nr. 125).


Tabela nr.125 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Vlorë, Dhjetor 2023

	Detyrime të Prapambetura	Totali i Shpenzimeve Faktike 2023	% e Detyrimeve ndaj Totalit të Shpenzimeve Faktike
Bashkia Vlorë	47,518,014	1,924,763,636	2.47%
Totali NJVQVB	4,752,754,032	68,336,294,762	6.95%
Mesatarja NJVQV-Bashki			9.51%

Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Treguesi i vështirësisë financiare ka qenë i ulët dhe në vitin e fundit është reduktuar në 2.47% në 2023. (Grafiku nr. 122).

Grafiku nr.122 Ecuria e Statutit të Vështirësisë Financiare të Bashkisë Vlorë 2019-2023



Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Sipas raportimit deri në dhjetor 2023, detyrimet janë rreth 48 milionë lekë, kryesisht për shpenzime kapitale dhe shpenzime korrente për detyrime të tjera (Tabela nr. 126).


Tabela nr.126 Struktura e Detajuar e Detyrimeve të Prapambetura të Bashkisë Vlorë, Dhjetor 2023 (në lekë)

Nr.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale faktike të NJVQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua afatgjatë	0		
a.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)			
a.2	Tituj të emetuar			
a.3	Garanci për të tretë	0		
b	Hua afatshkurtër			
b.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)			
b.2	Tituj të emetuar			
b.3	Garanci për të tretë			
II	Detyrimet e prapambetura	47,518,014		
Llogaria ekonomike	Emërtimi			
4864100	Vendime Gjyqesore			
4864200	Det.Prap. Sherbime	2,470,040		
4864201	Det.Prap. Energji Elektrike		1,924,763,636	2.47%
4864300	Det.Prap. Mirembajtje			
4864400	Det.Prap. Investime	27,959,393		
4864500	Det.Prap. Rimbursim TVSH			
4864600	Mallra	2,114,128		
4864900	Det.Prap. Te Tjera	14,974,453		
4864601	Det.Prap. Sig.Shoqerore			
4864602	Det.Prap. Sig.Shendet			
4864603	Det.Prap. Ardh.Personal			
4864604	Det.Prap. Tatime Tjera			
4864901	Paga			
4864902	Shpronetime			
4864903	Trans. Individeve			
4864904	Trans. Subjektet			
III	Totali (I+II)	47,518,014		

Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Në krahasim me 2022, në vitin 2023 kemi një rritje të lehtë të detyrimeve për shpenzime kapitale (Grafiku nr. 123).

Grafiku nr.123 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Vlorë 2019-2023



Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Bashkia Vorë

Detyrimet e prapambetura deri në dhjetor 2023 janë 50.91 % e shpenzimeve totale faktike në Bashkinë e Vorës, më shumë se 25% duke dëshmuar për një situatë në vështirësi financiare. Situata është mbi mesataren e % së Detyrimeve ndaj Totalit të Shpenzimeve Faktike mes të gjitha bashkive (9.51%) dhe mbi treguesin e totalit të detyrimeve të prapambetura ndaj shpenzimeve faktike të njëjësive vendore (6.95%) (Tabela nr. 127).


Tabela nr.127 Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Vorë, Dhjetor 2023

	Detyrime të Prapambetura	Totali i Shpenzimeve Faktike 2023	% e Detyrimeve ndaj Totalit të Shpenzimeve Faktike
Bashkia Vorë	363,290,371	713,623,961	50.91%
Totali NJVQVB	4,752,754,032	68,336,294,762	6.95%
Mesatarja NJVQV-Bashki			9.51%

Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Treguesi i vështirësisë financiare është përkeqësuar shumë në vitin 2020. Në vijim, treguesi është reduktuar duke arritur nivelin e 50.91% në 2023, sërish i lartë për bashkinë që klasifikohet si bashki në vështirësi financiare (Grafiku nr. 124).

Grafiku nr.124 Ecuria e Statutit të Vështirësisë Financiare të Bashkisë Vorë 2019-2023



Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Sipas raportimit deri në dhjetor, detyrimet janë rreth 363 milionë lekë, kryesisht për shpenzime kapitale dhe mirëmbajtje (Tabela nr. 128).


Tabela nr.128 Struktura e Detajuar e Detyrimeve të Prapambetura të Bashkisë Vorë, Dhjetor 2023 (në lekë)

Nr.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale faktike të NJVQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua afatgjatë	0		
a.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)			
a.2	Tituj të emetuar			
a.3	Garanci për të tretë	0		
b	Hua afatshkurtër			
b.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)			
b.2	Tituj të emetuar			
b.3	Garanci për të tretë			
II	Detyrimet e prapambetura	363,290,371		
Llogaria ekonomike	Emërtimi			
4864100	Vendime Gjyqesore	2,309,389		
4864200	Det.Prap. Sherbime		713,623,961	50.91%
4864201	Det.Prap. Energji Elektrike			
4864300	Det.Prap. Mirembajtje	81,886,827		
4864400	Det.Prap. Investime	279,094,155		
4864500	Det.Prap. Rimbursim TVSH			
4864600	Mallra			
4864900	Det.Prap. Te Tjera			
4864601	Det.Prap. Sig.Shoqerore			
4864602	Det.Prap. Sig.Shendet			
4864603	Det.Prap. Ardh.Personal			
4864604	Det.Prap. Tatime Tjera			
4864901	Paga			
4864902	Shpronesime			
4864903	Trans. Individeve			
4864904	Trans. Subjektet			
III	Totali (I+II)	363,290,371		

Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Në krahasim me vitin 2022, në vitin 2023 kemi një redukim të detyrimeve për shpenzime kapitale dhe rritje të detyrimeve për shpenzime korrente (Grafiku nr. 125).

Grafiku nr.125 Struktura e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Vorë 2019-2023



Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

**Analiza
mbi Treguesit e Përgjithshëm të
Detyrimeve të Prapambetura të Qarqeve**

Në bazë të të dhënave të mbledhura mbi detyrimet e prapambetura të 12 qarqeve, rezulton se ato përbëjnë vetëm 1.79% të totalit të detyrimeve të prapambetura të njësisve vendore në vitin 2023 (Tabela nr. 129). Në krahasim me vitin 2022, detyrimet e prapambetura nga qarqet shënojnë një ulje nga 1.9% që ishin në vitin 2022. Raporti i detyrimeve të prapambetura përkundrejt totalit të shpenzimeve faktike nga 12 qarqet është 9.66% në vitin 2023, më i lartë se treguesi respektiv për bashkitë (6.95%).

Tabela nr.129 Tregues të Detyrimeve të Prapambetura të NJVQV- Qarqe vs Bashki, Dhjetor 2023

Njësi Qeverisjes Vendore	Pesha kundrejt totalit të detyrimeve			Përqindja e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve faktike		
	2023	2022	2021	2023	2022	2021
Qark	1.79%	1.90%	1.82%	9.66%	17.31%	17.77%
Bashki	98.21%	98.10%	98.18%	6.95%	9.12%	12.40%

Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Në vitin 2023, shtatë qarqe nuk kanë asnjë detyrim të prapambetur dhe tre qarqe kanë tregues minimal të vështirësisë financiare duke dëshmuar që nuk kanë probleme financiare (Tabela nr. 130). Ndërkohë, qarqet e Durrësit dhe Beratit rezultojnë si qarqe në vështirësi financiare me tregues 45.68% dhe 34.82% respektivisht.


Tabela nr.130 Statusi i Vështirësisë në Njësi Vendore Qarqe, Dhjetor 2023

Statusi i Vështirësisë	Nr. i Qarqeve	Qarku	Detyrimi i mbetur deri në Dhjetor 2023 (SIFQ)	% e detyrimeve ndaj totalit të shpenzimeve faktike 2023
Pa Probleme Financiare	10	Qarku Dibër	0	0.00%
		Qarku Elbasan	0	0.00%
		Qarku Fier	0	0.00%
		Qarku Korçë	280,040	0.29%
		Qarku Kukës	0	0.00%
		Qarku Lezhë	0	0.00%
		Qarku Shkodër	0	0.00%
		Qarku Tiranë	0	0.00%
		Qarku Vlorë	1,274,000	1.35%
		Qarku Gjirokastrë	5,606,573	11.28%
Në Vështirësi Financiare	2	Qarku Durrës	40,294,774	44.79%
		Qarku Berat	39,114,901	41.16%

Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Më konkretisht, grafiku nr. 126 tregon detyrimet e prapambetura në përqindje të shpenzimeve faktike në 2023 nga të gjitha qarqet. Qarku i Beratit dhe i Durrësit janë qarqe në vështirësi financiare, shumë mbi mesataren (7.76%) e shënuar nga të gjitha qarqet në vitin 2023.


Grafiku nr.126 Detyrimet e prapambetura për Qarqet në përqindje të shpenzimeve faktike, Dhjetor 2023



Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Në krahasim me vitin 2022, treguesi i detyrimeve të prapambetura përkundrejt shpenzimeve faktike është përmirësuar për të gjitha qarqet (Grafiku nr. 127). Ndërkohë për për qarkun e Durrësit rezultojnë një përkeqësim me 12.9%. Të dyja qarqet e Durrësit dhe Beratit, mbeten ende si qarqe në vështirësi financiare.

Grafiku nr.127 Diferenca e përqindjes së detyrimeve përkundrejt shpenzimeve faktike (2023) dhe shpenzimeve të planifikuara (2022) për qarqet mes viteve 2023-2022



Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Përsa i përket strukturës së detyrimeve në qarqe për vitin 2023, 97.14% e detyrimeve të prapambetura janë për vendime gjyqësore, 2.20% e detyrimeve janë për shpenzime të tjera korrente dhe vetëm 0.67% janë për shpenzime kapitale (Tabela nr. 131). Në krahasim më vitin 2022, detyrimet e prapambetura për vendime gjyqësore dhe ato për shpenzime kapitale pësojnë një rritje të lehtë shoqëruar me uljen e detyrimeve të natyrës për shpenzime të tjera korrente.

Tabela nr.131 Struktura e detyrimeve të prapambetura 2023-2022 për qarqet

Struktura e detyrimeve	Vlera	Përqindja ndaj totalit të detyrimeve 2023	Përqindja ndaj totalit të detyrimeve 2022	Përqindja ndaj totalit të detyrimeve 2021
Vendime Gjyqësore	84,091,807	97.14%	95.85%	96.38%
Të tjera korrente	1,902,261	2.20%	3.59%	3.00%
Investime	576,220	0.67%	0.56%	0.62%

Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

Tabela nr. 132 pasqyron në mënyrë më të detajuar strukturën e detyrimeve për të gjitha qarqet. Vihet re se 100% dhe 98% e detyrimeve respektivisht në qarkun e Durësit dhe Beratit janë detyrime të prapambetura për vendimet gjyqësore. 95% e detyrimeve në qarkun e Gjirokastrës janë gjithashtu detyrime për vendime gjyqësore. Ndërkohë, detyrimet e prapambetura për qarkun e Korçës dhe të Vlorës janë të gjitha të natyrës së shpenzimeve të tjera korrente. Qarku i Beratit është qarku i vetëm që ka detyrime të prapambetura të natyrës së shpenzimeve kapitale.

Tabela nr.132 Struktura e detajuar e detyrimeve të prapambetura për qarqet

Statusi i Vështirësisë	Bashki	Vendime Gjyqësore		Të tjera korrente		Investime		Totali
		Vlera	Përqindja	Vlera	Përqindja	Vlera	Përqindja	
Pa Probleme Financiare	Qarku Dibër	0	0%	0	0%	0	0.00%	0
	Qarku Elbasan	0	0%	0	0%	0	0.00%	0
	Qarku Fier	0	0%	0	0%	0	0.00%	0
	Qarku Korçë	0	0%	280,040	100%	0	0.00%	280,040
	Qarku Kukës	0	0%	0	0%	0	0.00%	0
	Qarku Lezhë	0	0%	0	0%	0	0.00%	0
	Qarku Shkodër	0	0%	0	0%	0	0.00%	0
	Qarku Tiranë	0	0%	0	0%	0	0.00%	0
	Qarku Vlorë	0	0%	1,274,000	100%	0	0.00%	1,274,000
	Qarku Gjirokastrë	5,331,473	95%	275,100	5%	0	0.00%	5,606,573
Në Vështirësi Financiare	Qarku Durrës	40,294,774	100%	0	0%	0	0.00%	40,294,774
	Qarku Berat	38,465,560	98%	73,121	0.19%	576,220	1.47%	39,114,901

Burimi: SIFQ, Ministria e Financave




**Plani i Shlyerjes
së Detyrimeve të Prapambetura**

Bashkitë kanë paraqitur pranë Ministrisë së Financave planin tre-vjecar të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura për periudhën 2024-2026.

Në bazë të rakordimeve me Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë, vihet re se parashikohet të shlyen 67.72 % e totalit të detyrimeve të bashkive në vitin 2024, 19.74% e tyre në 2025 dhe 17.54% e tyre në 2026 (Grafiku nr. 128). Një trend i ndryshëm plan shlyerjeje vihet re për qarqet. Shumica e detyrimeve të qarqeve (73.02%) parashikohet të shlyen në vitin 2026, 13.99% e tyre në vitin 2025 dhe 12.99% e tyre në vitin 2024.


Grafiku nr.128 Plani i shlyerjes së detyrimeve për total qark dhe total bashki 2024-2026



Burimi: Vetëraportimet e NJVQV dhe SIFQ, Ministria e Financave

Në bazë të vetëraportimeve të bashkive, Grafiku nr. 129 paraqet planin e shlyerjeve për secilën bashki. Vihet re se 25 bashki parashikojnë të shlyejnë të gjitha detyrimet brenda vitit 2024, 20 bashki të tjera parashikojnë të shlyejnë më shumë se 50% të detyrimeve në vitin 2024 dhe pjesa tjetër e bashkive parashikojnë shlyerjen deri në vitin 2026. Mesatarisht bashkitë parashikojnë të shlyejnë 74% të detyrimeve në vitin 2024, 16% në 2025 dhe 10% në 2026. Bashkia e Kavajës, Vorës, Dimalit, Cërrikut dhe Klosit parashikojnë të shlyejnë respektivisht 30%, 40%, 71%, 40% dhe 100% të detyrimeve në vitin 2024.


Grafiku nr.129 Plani i shlyerjes së detyrimeve për secilën bashki 2024-2026



Burimi: Vetëraportimet e NJVQV dhe SIFQ, Ministria e Financave

Në bazë të vetëraportimeve, grafiku nr. 130 paraqet planin e shlyerjes së detyrimeve nga qarqet me detyrime të prapambetura. Qarku i Durrësit dhe i Beratit që kanë edhe 93% të detyrimeve të qarqeve parashikojnë të shlyejnë 76% dhe 81% të detyrimeve respektivisht në vitin 2026. Ndërkohë, qarku i Korçës dhe i Gjirokastrës parashikojnë të shlyejnë 57% dhe 59% të detyrimeve respektivisht në vitin 2024.

Grafiku nr.130 Plani i shlyerjes së detyrimeve për Qarqet 2024-2026




Burimi: Vetëraportimet e NJVQV dhe SIFQ, Ministria e Financave

Është e rëndësishme të monitorohet zbatimi i planit të shlyerjes sikurse vetëraportohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Referuar planit të shlyerjes së detyrimeve në vitin 2022, 53% e detyrimeve u parashikuan të shlyeshin në vitin 2023, 17% në vitin 2024 dhe 30% në vitin 2025. Në fakt, vetëm 1/5 e planit ose jo më shumë se 11% e detyrimeve u shlyen në vitin 2023.

Grafiku nr. 131 pasqyron shlyerjen/ shtimin e detyrimeve në vlerë absolute për secilën bashki. 18 bashki kanë rritur stokun e detyrimeve të prapambetura, në vend të reduktimit të tij.

Grafiku nr.131 Shlyerja/shtimi i detyrimeve për secilën bashki në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022



Burimi: SIFQ, Ministria e Financave

The background features a vibrant orange color with several overlapping, semi-transparent pink and magenta geometric shapes. These shapes include triangles and polygons that create a layered, architectural effect. The shapes are positioned primarily on the left and top-left sides, extending towards the center of the page.

Konkluzione dhe Rekomandime

Konkluzione

- Konstatohet se krijimi i detyrimeve të prapambetura mund të rezultojë për shkak se menaxhimi financiar në disa bashki është i dobët ku bashkitë nuk arrijnë të planifikojnë dhe zbatojnë efektivisht buxhetet e tyre. Kjo tregon mungesë të disiplinës financiare dhe keq menaxhim të fondeve buxhetore.
- Stoku i detyrimeve të prapambetura deri në fund të dhjetorit të vitit 2023 për bashkitë është 4,8 miliardë lekë (4,752,754,032 lekë) dhe për qarqet 86,570,288lekë; në total 4,839,324,320 lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022, kur ishte 5.4 miliardë lekë, stoku i detyrimeve të prapambetura në nivel vendor rezulton të ketë pësuar rënie me rreth 11%. Nisur nga impakti financiar që ka krijimi i detyrimeve të prapambetura, një vëmendje të veçantë merr (i) rëndësia që kryetarët e bashkive duhet t'i kushtojnë menaxhimit të borxhit të prapambetur dhe kujdesit në marrjen përsipër të angazhimeve të reja, si dhe (ii) domosdoshmëria e monitorimit të ngushtë deri në kontroll direkt të angazhimeve publike që duhet të ushtrojë Ministria e Financave në bashkitë që rezultojnë me vështirësi financiare deri në paaftësi paguese.
- Referuar analizës sipas bashkive konstatohet se, në vitin 2023 pesë bashki kanë një status si njësi në vështirësi financiare, konkretisht bashkitë: Kavajë, Vorë, Dimal, Cërrik dhe Klos. Tetë bashki kanë probleme financiare, konkretisht bashkitë: Memaliaj, Peqin, Pogradec, Roskovec, Rrogozhinë, Delvinë, Dibër. 48 bashki të tjera nuk kanë probleme financiare.
- Referuar analizës së qarqeve konstatohet se në vitin 2023 qarku i Beratit dhe i Durrësit janë qarqe në vështirësi financiare. Ndërkohë qarqet e tjera nuk kanë probleme financiare.
- Një performancë të mirë kanë patur bashkitë: Korçë, Shkodër, Sarandë, Berat, Fier, Vlorë, Tiranë, Lushje, Kamëz, Elbasan, Durrës me stok njëshifror më të vogël se 10% të detyrimeve të prapambetura përkundrejt shpenzimeve faktike. Vihet re se bashkitë që shfaqin probleme financiare apo janë në vështirësi financiare janë të gjitha bashkitë me shpenzime faktike për frymë për vitin 2023 nën mesataren prej 19,420 lekë për banorë, me përjashtim të bashkisë së Vorës.
- Tridhjetë e shtatë bashki kanë ulur stokun e detyrimeve të prapambetura në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022.
- Bashkitë Polican, Tropojë, Libohovë rezultojnë si bashki pa probleme financiare në 2023 nga bashki me probleme financiare në vitin 2022.
- Tetëmbëdhjetë bashki e kanë rritur stokun e detyrimeve në 2023 dhe për rrjedhojë statusi i vështirësisë financiare është përkeqësuar. Kështu, bashkitë Roskovec, Memaliaj dhe Rrogozhinë nga bashki pa probleme financiare në vitin 2022 rezultojnë të jenë në vitin 2023 bashki me probleme financiare. Bashkia e Klosit nga një bashki pa probleme financiare në vitin 2022 rezulton në një bashki në vështirësi financiare në vitin 2023.
- Bashkitë Patos dhe Këlcyrë nuk kanë detyrime të prapambetura, 4 bashki kanë të njëjtën vlerë të detyrimeve si në vitin 2022 edhe në vitin 2023, konkretisht bashkitë Kolonjë, Mallakastër, Rrogozhinë dhe Shkodër.
- Në lidhje me strukturën e detyrimeve të prapambetura, vihet re se 61 bashkitë kanë rreth 7.2% të detyrimeve të prapambetura për vendimeve gjyqësore, 47.4% e tyre janë të natyrës së shpenzimeve për investime dhe rreth 45.4% janë për shpenzime të

tjera korrente. Në bazë totalit të detyrimeve për të gjitha bashkitë sipas kategorive, në dallim nga viti 2022, vihet re një reduktim i detyrimeve për vendime gjyqësore, rritje e detyrimeve të natyrës së shpenzimeve të tjera korrente dhe ulje të detyrimeve për shpenzime kapitale.

- Shumica e bashkive me detyrime mbi 15% ndaj shpenzimeve faktike kanë më shumë detyrime të natyrës së shpenzimeve kapitale, me përjashtim të bashkive Peqini, Kavajë, dhe Pogradec. Bashkitë Klos dhe Rrogozhinë kanë përqindjen më të lartë të detyrimeve për shpenzime kapitale respektivisht 100% dhe 99.39%. Bashkia e Peqinit ka përqindjen më të lartë të detyrimeve për vendime gjyqësore (27.22%). Bashkitë Kavajë, Peqin dhe Pogradec kanë përqindjen më të lartë të detyrimeve për shpenzime të tjera korrente respektivisht 92.27%, 56.78% dhe 58.05%.
- Dy qarqet në vështirësi financiare: Berati dhe Durrësi kanë detyrime të prapambetura kryesisht për vendime gjyqësore duke u luhatur nga 98% në 100% të totalit të detyrimeve të prapambetura respektive.

Rekomandime

- ✓ Detyrimet e prapambetura janë një pengesë e konsiderueshme në mirëmenaxhimin e financave vendore, duke sjellë probleme në realizimin e shpenzimeve publike për ofrimin e shërbimeve dhe kryerjen e investimeve. Një ndër arsytet e krijimit të detyrimeve të prapambetura është marrja e angazhimeve, pa patur burime financiare në dispozicion (duke miratuar buxhetin me një plan të fryrë të ardhurash, jo realist). **Bashkitë dhe Qarqet duhet të jenë të kujdesshme në planifikimin e buxhetit, duke vlerësuar burimet e mundshme të financimit të shpenzimeve dhe kapacitetet e tyre të mundshme fiskale. Gjithashtu një analizë e thelluar e kostos së shpenzimeve është e rëndësishme në funksion të një planifikimi buxhetor sa më të saktë.**
- ✓ **Angazhimi në detyrime kontraktuale duhet të jetë i kujdesshëm në bazë të një monitorimi të vazhdueshëm të zbatimit të buxhetit.** Ndërmarrja e angazhimeve kontraktuale pavarësisht ritmeve të ulta të zbatimit të buxhetit përkeqëson statusin e vështirësisë financiare të njësisve vendore. Po kështu edhe **shlyerja e detyrimeve të prapambetura duhet të programohet gjatë planifikimit të buxhetit dhe të zbatohet me përparësi nga njësitë vendore.**
- ✓ Problematikat në zbatimin e kontratave janë të shumta, që rëndojnë si bashkitë ashtu edhe firmat private që kanë përfituar këto kontrata investimesh. Në vitin 2023, konstatohet se detyrimet për punë të kryera, pra investime të realizuara dhe të papaguara përbëjnë rreth 50% të totalit të detyrimeve. **Si rrjedhojë, duhet disiplinuar kryerja e investimeve në kohë sipas përcaktimeve të detyrimeve kontraktuale. Fondet të cilat angazhohen për investime duhet të përdoren në kohë dhe me efektivitet.**
- ✓ **Të gjitha bashkitë dhe qarqet duhet të ndjekin periodikisht (çdo muaj) situatën e detyrimeve të prapambetura dhe duhet të marrin masa për moskrijimin e tyre.** Njësitë e vetëqeverisjes vendore në bashkëpunim me degët përkatëse të thesarit brenda datës 20 të muajit pasardhës, duhet të rakordojnë të dhënat e muajit të mëparshëm mbi të ardhurat sipas llojit, shpenzimeve sipas llogarive ekonomike e burimit të financimit nëpërmjet aneksit 2, dhe detyrimeve të prapambetura nëpërmjet aneksit 1, bashkëlidhur udhëzimit nr. 35, datë 29.12.2023 "Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore".

- ✓ **Për disa bashki e qarqe të cilat janë me probleme ose vështirësi financiare, është konstatuar se bashkia/ qarku nuk i ka marrë masat për zbatimin e planit të veprimit për uljen e detyrimeve dhe përmirësimin e gjendjes financiare, por ka vazhduar të rrisë stokun duke rrezikuar të kalojnë në fazat më problematike të vështirësive financiare.** Si rrjedhojë, të gjitha bashkitë dhe qarqet të cilat konstatohen me probleme financiare/vështirësi financiare, me qëllim shlyerjen e detyrimeve të prapambetura:
 - duhet të ulin vlerën e detyrimit të prapambetur duke mos ndërmarrë angazhime të reja;
 - mund të propozojnë ristrukturimin e treguesve fiskalë, si në të ardhura edhe në shpenzime;
 - mund të rishikojnë planin e të ardhurave vendore, kryesisht burimet e financimit nga të ardhurat e veta, duke rivlerësuar mundësitë për rritjen e taksave/tarifave;
 - duhet të likujdojnë pjesërisht detyrimin duke kryer rialokime apo dhe shkurtime në shpenzimet e veta, ose të nënshkruhet një marrëveshje për shlyerje pjesore të detyrimit me palën përfituese.
- ✓ Bashkitë dhe qarqet mund të shlyejnë një pjesë të detyrimeve të prapambetura me fondet e planifikuara për vitin 2024, dhe të vazhdojnë të ndjekin grafikun e pagesave sipas planifikimit, duke respektuar parimin e kohës së krijimit të detyrimit sipas natyrës së shpenzimit.
- ✓ Të gjitha bashkitë dhe qarqet të cilat rezultojnë me probleme/vështirësi financiare duhet të miratojnë planin e detajuar të menaxhimit të riskut të krijimit/shtimit të detyrimeve të prapambetura dhe të raportojnë mbi bazën e këtij plani. Këto bashki dhe qarqet duhet të përgatisin një raport ku të evidentojnë:
 - shkaqet që sjellin akumulimin e detyrimeve financiare të prapambetura për bashkinë.
 - reagimin/vendimet e menaxhimit të lartë (Kryetari, Këshilli Bashkiak, Qarku), gjatë periudhës së raportimit, për parandalimin apo trajtimin e riskut të krijimit/shtimit të detyrimeve të prapambetura me qëllim mos rëndimin e situatës financiare të bashkisë.
 - vështirësitë që ka hasur bashkia për shlyerjen e detyrimeve financiare të prapambetura.
 - masat e mëtejshme të planifikuara për menaxhimin e riskut në të ardhmen, si plani i shlyerjes së detyrimeve financiare të prapambetura.
- ✓ **Bashkitë Dibër, Delvinë, Rrogozhinë, Roskovec, Devoll, Pogradec, Peqin dhe Memaliaj, të cilat rezultojnë me probleme financiare, duhet:**
 - të hartojnë planin e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura, të monitorojnë zbatimin e këtij plani, dhe të përgatisin një plan masash për daljen nga situata e problemeve financiare deri në 12 muaj nga momenti i konstatimit të situatës.
 - njoftojnë Këshillin, i cili duhet të miratojë vendimin për zbatimin e planit të shlyerjes së detyrimeve. Planet e miratuara nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore duhet të dërgohen zyrtarisht në Ministrinë e Financave.
 - çdo muaj të njoftojnë Ministrinë e Financave për masat të cilat do të ndërmerren dhe për ecurinë e zbatimit të tyre, për të kthyer bashkinë në gjendje normale financiare.
 - nëpër çdo ndryshim të këtyre planeve deri në kthimin në normalitet të njoftojnë Ministrinë e Financave.

- ✓ **Për bashkitë Klos, Cërrik, Dimal, Vorë dhe Kavajë, si dhe Qarqet Durrës dhe Berat, të cilat rezultojnë me vështirësi financiare:**
- Kryetari i bashkisë/ qarkut duhet të përgatisë një plan (plani i rehabilitimit) për daljen nga situata e vështirësisë financiare dhe tja dërgojë Këshillit të Bashkisë.
 - Bashkia/ qarku duhet të marrë masat e duhura që funksionet dhe shërbimet e nevojshme për bashkinë të mos çënohen dhe të funksionojnë normalisht.
 - Kryetari i bashkisë/ qarkut duhet ta dërgojë këtë plan për komente në Ministrinë e Financave.
 - Këshilli duhet të shqyrtojë dhe miratojë planin brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes.
 - Plani i miratuar nga Këshilli Bashkiak/ Qarkut do t'i dërgohet zyrtarisht Ministrisë së Financave.
 - Ministria e Financave, sipas rastit do të japë rekomandime konkrete për përmirësimin e situatës së vështirësisë financiare.
 - Ministria e Financave njofton degët e thesarit ku operojnë këto bashki për planin e rehabilitimit financiar.
 - Kryetari i njësisë duhet të ngrejë një njësi, pjesë e administratës së bashkisë, e cila do të jetë përgjegjëse për koordinimin, zhvillimin dhe zbatimin e planit të rehabilitimit.
 - Kryetari i bashkisë/ qarkut njofton çdo muaj Këshillin dhe Ministrinë e Financave për zbatimin e planit të masave për daljen nga situata e vështirësisë financiare.
 - Për çdo iniciativë ndryshimi apo rivlerësimi të planit të rehabilitimit financiar, bashkia duhet të njoftojë Ministrinë e Financave.

